



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

*I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

Së pari, ju falenderoj për ftesën për të prezantuar Raportin Vjetor për vitin 2020 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Viti 2020 ishte një vit i vështirë dhe i pazakontë për ekonominë dhe sektorin financiar. Efektet e pandemisë COVID-19, si edhe pasojat e tërmeteve të fundvitit 2019 sollën sfida serioze për shoqëritë që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje, si edhe për vetë Autoritetin.

Sidoqoftë, sektori financiar jobankar rezultoi se u rezistoi efekteve të pandemisë dhe përgjithësisht paraqitet i qëndrueshëm, me tregues të mirë likuiditeti, si edhe të mbulimit me provigjone. Totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit u rrit me 1.5% në fund të vitit 2020, duke arritur në rreth 110 miliardë lekë. Procesi i dëmshpërblimeve të tërmeteve vlerësohet se u menaxhua me korrektësi nga shoqëritë e sigurimit, të cilat deri në fund të vitit të kaluar paguan mbi 90% të praktikave të dëmeve nga afro 6300 kërkesa për dëmshpërblim.

Vlen të theksohet se bazuar në treguesit e muajve të parë të vitit 2021, tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit po i kthehen normalitetit, duke shënuar rritje të të ardhurave dhe të aseteve neto. Kështu, tregu i sigurimeve e mbylli 3-mujorin e parë të këtij viti me një rritje prej 12.5% të të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe asetet neto të tregut të investimeve dhe tregut të pensioneve private shënuan rritje për 3-mujorin e parë, respektivisht me 2.4% dhe 5%.

Në përgjigje të situatës së jashtëzakonshme pandemike, përgjatë vitit 2020, AMF mori një sërë masash në funksion të garantimit të stabilitetit financiar dhe vijueshmërisë së veprimtarisë së operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje. Në linjë me rekomandimet e rregullatorëve evropianë, Autoriteti u kërkoi shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale planet e përballimit të krizave, ndërkohë që rishikoi planin e tij të vazhdimësisë në raste të jashtëzakonshme. Për ruajtjen e gjendjes së likuiditetit, me vendim të Autoritetit, u pezullua shpërndarja e dividendit për shoqëritë e sigurimit. Bordi i Autoritetit miratoi një udhëzim të posaçëm për shoqëritë e tregjeve nën mbikëqyrje, në funksion të rritjes së transparencës për mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit.

Viti 2020 ishte një vit i rëndësishëm në kuadër të ndryshimeve ligjore dhe rregullatore, si edhe përafrimit me direktivat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në këtë drejtim, miratimi i ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” plotëson rekomandimet e përsëritura të Komisionit Evropian, të shprehura edhe në progres-raportet e viteve të fundit për Shqipërinë, si edhe pritet të përmirësojë disa aspekte të funksionimit të tregut të sigurimeve dhe të sjellë lehtësime për qytetarët.

Gjithashtu, në progres-raportin e Komisionit Evropian theksohet se miratimi i ligjeve të reja “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe “Për tregjet e kapitalit” përafron kuadrin ligjor të Shqipërisë me direktivat evropiane. Autoriteti është angazhuar gjatë këtij viti edhe në përshtatjen e Ligjit “Për fondet e pensionit vullnetar” me qëllim përafrimin me kuadrin ligjor evropian dhe nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të tregut të pensioneve private.

Si institucioni drejtues i kapitullit 9 “Shërbimet financiare” në negociatat e anëtarësimit, Autoriteti ka monitoruar zbatimin e kërkesave të përafrimit, si edhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Gjithashtu Autoriteti ka evidentuar nevojat për plotësime ligjore dhe rregullatore sa i përket kapitullit 9, ndërsa ka dhënë kontributin e tij për disa nga kapitujt e tjerë në procesin e negociatave të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Në vëmendje të Autoritetit përgjatë vitit 2020 ka qënë edhe plotësimi i rekomandimeve të Komitetit të MONEYVAL, ku janë realizuar përmirësime në rregulloret e tregjeve nën mbikëqyrje, që lidhen me aspekte të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Masat e marra, si në kuadrin rregullator, ashtu edhe atë mbikëqyrës janë reflektuar edhe në raportin e MONEYVAL, i cili konstaton se përgjithësisht tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit kategorizohen me nivel të ulët rreziku.

Sa i përket ecurisë në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit gjatë vitit 2020,

Tregu i sigurimeve, pavarësisht efekteve të pandemisë që solli rënie të të ardhurave me 5.7% në nivel primesh bruto, performoi mirë, duke rritur kapitalet e veta, aftësinë paguese, si edhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike. Për vitin e kaluar, totali i dëmeve të paguara bruto u rrit me 17.4% krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 7.5 miliardë lekë, ndikuar kryesisht nga pagesat e dëmeve të tërmeteve.

Tregu i fondeve të investimeve rezulton se i ka rikuperuar shlyerjet neto negative të 3-mujorit të dytë të vitit 2020 dhe e mbylli vitin me një rritje prej 1% në vlerë asetesh neto, duke arritur në 67.4 miliardë lekë.

Rritje shënoi edhe **tregu i fondeve të pensioneve private**, si në total asetesh, ashtu edhe në numër anëtarësh. Megjithatë, vlera neto e asetëve të këtij tregu mbetet modeste dhe me potencial të konsiderueshëm për t’u zhvilluar më tej.

Tregu i kapitaleve mbeti i përqendruar te tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i obligacioneve private. Gjatë vitit të kaluar pati një rritje të interesit për emetimin e obligacioneve me ofertë private. Tregu i kapitaleve është plotësuar edhe me infrastrukturën e pastregtimit.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Gjatë vitit 2021, fokusi kryesor i veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohet në:

Ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe mbikëqyrjen efektive të tregjeve, duke synuar avancimin drejt mbikëqyrjes së plotë me fokus rrezikun.

Plotësimin e kuadrit nënligjor, në funksion të rregullimit, por edhe zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje, përmes hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore për të bërë tërësisht të zbatueshëm ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si edhe ligjet e tjera për tregjet e kapitalit dhe për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse përmes asistencës teknike të Bankës Botërore, ku synohet një vlerësim i përputhshmërisë së kuadrit ligjor dhe praktikave mbikëqyrëse të Autoritetit me parimet bazë ndërkombëtare në fushën e sigurimeve.

Avancimin me proceset e digjitalizimit dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, në funksion të modernizimit dhe lehtësimit të procedurave të mbikëqyrjes, rritjes së eficiencës dhe krijimit të lehtësirave për qytetarët përmes e-shërbimeve.

Draftimin dhe zbatimin e një dokumenti strategjik për edukimin financiar dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për tregjet financiare, edhe në funksion të mbrojtjes së personave të siguar dhe investitorëve.

Në fund, më lejoni të theksoj se Autoriteti do të ndjekë me përparësi dhe do të angazhohet në vazhdimësi për plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit, të shprehura përmes rezolutës që do të miratohet në këtë seancë plenare.

Shumë faleminderit!